



**BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO**  
**AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE I KOSOVËS**  
**BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA**

33 Garibaldi Street Prishtina Kosovo UNMIK  
Phone: +381 38 222 055 Fax: +381 38 243 763 Web: www.bpk-kos.org

Në përputhje me pushtetin dhe autoritetin akorduar nga Neni 5, 6 dhe 51 i **Rregullores** së UNMIK Nr. 2001/24 Mbi Ndryshimin e **Rregullores** së UNMIK Nr. 1999/20 mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, **Rregullores** së UNMIK Nr. 1999/4 Mbi Valutën e Lejuar për përdorim në Kosovë, **Direktivës Administrative** së UNMIK Nr. 2001/24 mbi Ndryshimin e **Direktivës Administrative** së UNMIK Nr. 1999/2, Zbatimin e **Rregullores** së UNMIK Nr. 1999/4 mbi Monedhën e Lejuar për përdorim në Kosovë, dhe në përputhje me Rregullin e Këshillit të BE-s Nr. 1338/2001 të datës 28 Qershor 2001 mbi vendosjen e masave për mbrojtjen e euros kundër falsifikimit, si edhe në përputhje me orientimet e Bordit Drejtues së BPK-s miratuar në takimin e tij të datës 20 maj 2004 dhe rikonfirmuar në takimin e tij të date 26 janar 2005.

Nëpërmjet kësaj BPK lëshon si vijon:

### **Udhëzim Nr. 3**

#### **Mbi Standartet Minimale për Klasifikimin e Gjendjes së Kartmonedhave Euro nga Palët Tregtare**

Neni 1

#### **Synimi**

Ky Udhëzim u adresohet të gjitha institucioneve financiare që veprojnë në Kosovë, dhe që janë të licensuara nga Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës (BPK), duke përfshirë vetë BPK-n.

Neni 2

#### **Qëllimi**

Qëllimi i këtij Udhëzimi është saktësimi i standarteve minimale të klasifikimit për kontrollet e gjendjes së kartmonedhave euro.

Neni 3

#### **Shënime të përgjithshme**

Standartet minimale të klasifikimit për kontrollet e gjendjes së kartmonedhave euro, të vendosura nga ky Udhëzim, janë në përputhje me të njëjtat standarte të klasifikimit të gjendjes miratuar nga Sistemi-Euro i Bankave Qendrore Kombëtare.

## Neni 4

### Saktësim

Të paktën 95 për qind e kartmonedhave, të cilat nuk janë në përputhje me kriteret e gjendjes të vendosura nga ky Udhëzim, duhet të hiqen nga qarkullimi.

## Neni 5

### Përvijim i Kërkesave Minimale për Klasifikimin e Gjendjes

Lista e mëposhtme përfshin tiparet që kanë të bëjnë me kontrollin e gjendjes së kartmonedhave euro:

<b>Nr.</b>	<b>Tipari</b>	<b>Përkufizimi</b>
1.	Njolloosje	Përhapje e përgjithshme e pisllekut përgjatë gjithë kartmonedhës
2.	Dobësim	Dëmtim strukturor që çon në mungesën e ngurtësisë
3.	Palosje e fletës	Kënde të palosura
4.	Grisje	E vetëkuptueshme
5.	Vrima	E vetëkuptueshme
6.	Gjymtim	Kartmonedhë me pjesë që mungojnë, duke përfshirë të paktën një cep (në dallim nga vrimat)
7.	Riparimet	Pjesë të së njëjtës kartmonedhë të bashkuara së bashku me shirit ngjitës ose ngjitës
8.	Kartmonedhë e përbërë	Një kartmonedhë e përbërë nga pjesë prej kartmonedhave të ndryshme
9.	Njollë	Përqëndrim i lokalizuar i pisllekut
10.	Mbishkrime	Ndryshim grafik i kartmonedhës i bërë me qëllim
11.	Zhubravitje	Palosje e rastësore e shumëfishtë
12.	Kartmonedhë pa bojë	Mungesë e bojës në disa pjesë ose në gjithë kartmonedhën, p.sh. një kartmonedhë e larë
13.	Palosjet	E vetëkuptueshme

#### 5.1. Njolloosja

Njolloosja e kartmonedhave rrit vëllimin pamor të kartmonedhave dhe zvogëlon pasqyrimin e tyre. Të mëposhtmet saktësojnë nivelin e njolloosjes së modeleve në kufi të gjendjes jo të mirë të kartmonedhave për të cilat ende mendohet si të përshtashme për riciklim:

Emërtimi	Ndryshimi i vëllimit maksimal midis modelit në kufi të gjendjes jo të mirë dhe kartmonedhës së re*	Pasqyrimi minimal, të cilën modeli në kufi të gjendjes jo të mirë duhet të shfaqë	Filtri
----------	--	---	--------

---

\*/. Matjet duhet të merren në zonën e stampuar, e jo në zonën e vizatimit të padukshëm. Çdo institucion financiar mban kartmonedha reference që tregojnë një nivel njolloosjeje nga shifrat e lartpërmendura. Kartmonedhat e njolloosura në qarkullim që shfaqin nivel njolloosjeje më të lartë visual sesa këto kartmonedha duhet të klasifikohen si në gjendje jo të mirë.

5 EUR	0.06	87%	I kaltër
10 EUR	0.06	87%	I purpurt
20 EUR	0.06	87%	I kaltër
50 EUR	0.07	85%	I purpurt
	0.08	83%	I verdhë
100 EUR	0.06	87%	I kaltër
	0.07	85%	I verdhë
200 EUR	0.05	89%	I verdhë
500 EUR	0.04	91%	I purpurt

## 5.2. Dobësimi

Kartmonedhat me një ngurtësim shumë të ulët duhet të ndahen veçmas, sa më larg që të jetë e mundur. Për shkak se dobësimi normalisht ka lidhje me njollosjen, mund të pritët që pjesa më e madhe e këtyre kartmonedhave mund të zbulohen gjithashtu prej sensorëve të njollës kur klasifikohen mekanisht.

## 5.3. Palosja e fletës

Palosjet e fletës me një hapësirë prej më shumë se 130 mm<sup>2</sup> dhe me gjatësi minimale të cepit më të vogël më të madh se 10mm duhet të klasifikohen si në gjendje jo të mirë. Në rastet kur klasifikimi bëhet në mënyrë manuale, palosjet e fletës mund të shpalosen.

## 5.4. Grisjet

Aftësia e makinave të klasifikimit për të zbuluar grisjet është e kufizuar në varësi të vendndodhjes (drejtimit) të grisjeve. Kartmonedhat Euro me grisje më të mëdha se të mëposhtmet:

<b>Drejtimi</b>	<b>Gjerësia</b>	<b>Gjatësia</b>
Vertikal	4 mm	8 mm
Horizontal	4 mm	15 mm
Diagonale	4 mm	18 mm*

duhet të klasifikohen si në gjendje jo të mirë nëse ato janë “të hapura” dhe të ndodhura jashtë zonës së mekanikës transportuese së makinës.

\*/. Matur nga vizatimi i një vije të drejtë nga maja e grisjes deri tek cepi i kartmonedhës ku fillon grisja (projektim drejtkëndor), më mirë sesa të masësh gjatësinë e vetë grisjes.

### 5.5. Vrimat

Kartmonedhat Euro me vrima, të cilat nuk janë pjesërisht ose tërësisht të mbuluara nga rripi (-at) e transportit të makinës duhet të klasifikohen si në gjendje jo të mirë nëse zona e vrimës është më e madhe sesa 10 mm<sup>2</sup>.

### 5.6. Gjymtimet

Kartmonedhat Euro, gjatësia e së cilave zvogëlohet me 6 mm ose gjerësia e së cilave zvogëlohet me 5 mm duhet të klasifikohen si në gjendje jo të mirë. Të gjitha matjet kanë të bëjnë me ndryshimet nga gjatësitë dhe gjerësitë nominale të kartmonedhave euro.

### 5.7. Riparimet

Pjesët e së njëjtës kartmonedhë të bashkuara së bashku, për shembull duke përdorur shirit ngjitës ose ngjitës, krijojnë një kartmonedhë euro të riparuar. Ky përkufizim nuk përfshin kartmonedhat euro të përbëra prej pjesësh nga kartmonedha të ndryshme euro (shih 5.8.).

Shiriti ngjitës, përmasa e së cilit është më e madhe se 10 mm nga 40 mm, duhet të zbulohet dhe kartmonedha duhet të klasifikohet si në gjendje jo të mirë.

Shiriti ngjitës, përmasa e së cilit është dy të tretat e gjatësisë ose gjerësisë së kartmonedhës dhe gjerësia e së cilit është më shumë sesa 10 mm, duhet të zbulohet dhe kartmonedha duhet të klasifikohet si në gjendje jo të mirë.

Shiriti ngjitës, trashësia e së cilit është më shumë sesa 50 mm, duhet të zbulohet dhe kartmonedha duhet të klasifikohet si në gjendje jo të mirë.

### 5.8. Kartmonedhat e përbëra

Kartmonedhat e përbëra krijohen kur kartmonedhat euro ndahen qëllimisht në disa pjesë, e kur vetëm disa prej tyre bashkohen më pas së bashku, ose kur pjesë të kartmonedhave të ndryshme euro bashkohen së bashku, në mënyrë që të krijohen kartmonedha euro shtesë.

Për shkak se kartmonedhat e përbëra euro ndryshojnë nga kartmonedhat e vërteta nga përmasa e tyre e zvogëluar, trashësia dhe nga prishja e imazhit, zbuluesit e makinave të përmasave, trashësisë ose imazhit mund t'i identifikojnë këto kartmonedha.

### 5.9. Njollat

Njollat mund të identifikohen vetëm si njolllosje ose nëse ato ndryshojnë në mënyrë domethënëse formën e kartmonedhës euro. Nuk ka kërkesë të detyrueshme.

### 5.10. Mbishkrimet

Për shkak se kohët e fundit vetëm pak makina janë të pajisura më sensorë ndaj zbulimit të mbishkrimeve nuk specifikohen kritere gjendjeje. Nuk ka kërkesë të detyrueshme.

### 5.11. Zhubravitjet

Kartmonedhat e zhubravitura mund të identifikohen normalisht nëse niveli i tyre i reflektimit ose i dobësisë është i zvogëluar. Nuk ka kërkesë të detyrueshme.

### 5.12. Kartmonedhat pa bojë

Kartmonedhat euro pa bojë mund të ndodhin, për shembull, në rastet kur ato janë larë ose i janë nënshtruar përbërësve energjik kimik. Zbuluesit e imazhit ose zbuluesit UV të vërtetësisë mund t'i zbulojnë këto lloje të kartmonedhave në gjendje jo të mirë.

### 5.13. Palosjet

Sensorët që kontrollojnë përmasat e kartmonedhave për shkak të gjatësisë ose gjerësisë së tyre të zvogëluar, mund të zbulojnë kartmonedhat euro të palosura. Përveç kësaj, sensorët e trashësisë mund t'i zbulojnë ato. Megjithatë, për shkak të kufizimeve teknike vetëm palosjet që plotësojnë kriteret e përmendura për gjymtimet (pra palosjet që çojnë në një zvogëlim në gjatësi më të madhe sesa 6 mm ose në një zvogëlim në gjerësi më të madhe se 5 mm) mund të identifikohen.

## Neni 6

### **Detyrimet dhe Sanksionet**

Në bashkëpunim me Sistemin-Euro të Bankave Qëndrore Kombëtare dhe Bankën Qëndrore Evropiane, Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës, do të ndihmojë në ofrimin e testeve për makinat e shqyrtimit të kartmonedhave dhe për pajisje të tjera prekëse të kartmonedhave, sipas një procedure të përbashkët për të verifikuar që makinat e klasifikimit të prezantuara nga pjesëmarrësit në treg përputhen me standartet minimale të klasifikimit.

Aplikantët e testit që kanë kryer teste të tilla marrin dokumentacion mbi rezultatet e marra.

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës ka të drejtën e përmirësimit të mëtejshëm të këtyre standarteve në bashkëpunim me Bankën Qëndrore Evropiane ose Bankat Qëndrore Kombëtare të Sistemit-Euro.

Në rast mospërputhjeje të vazhdueshme me këtë udhëzim, Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës ka të drejtën e përjashtimit të bankave individuale për një kohë të caktuar nga depozitimet në procedurat e depozitimeve me shumicë.

## Neni 7

### **Hyrja në Fuqi**

Ky Udhëzim do të hyjë në fuqi në datën 14 mars 2005.